




PËLQIMI

Bazuar në :

**Opinionin e Grupit të Punës Neni 29 të Direktivës
95/46 /EC për mbrojtjen e të dhënave për
përkufizimin e “pëlqimit”.**

KDIMDP



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**

**INFORMATION AND
DATA PROTECTION
COMMISSIONER**

Pëlqimi është një prej bazave ligjore për përpunimin e të dhënave personale.

Historia legislative, veçanërisht në BE, tregon se **pëlqimi** ka luajtur një rol të rëndësishëm në kuptimin e mbrojtjes së të dhënave dhe privatësisë.

Në të njëjtën kohë, pëlqimi është konsideruar si bazë ligjore për legjitimimin e përpunimit të të dhënave.

Në nivelin e Bashkimit Evropian, mbështetja në pëlqim si kriter ligjshmërie për përpunimin e të dhënave personale, u përcaktua qysh në fillim të procesit legjislativ që përfundoi me miratimin e **Direktivës 95/46/EC**.

Roli i pëlqimit u njoh në mënyrë të qartë edhe në **Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së** duke përfshirë mbrojtjen e të dhënave personale.

Pëlqimi është përdorur në Direktivë, si bazë e përgjithshme për ligjshmërinë (Neni 7) dhe si një bazë e veçantë në disa kontekste të caktuara (Neni 8.2 (a), Neni 26.1 (a)). **Neni 7** citon pëlqimin si baza e parë nga gjashtë baza të ndryshme për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale.

Ndërsa Neni 8 parashikon mundësinë e përdorimit të pëlqimit për të legjitimuar përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave (sensitive) të cilat përndryshe janë të ndaluara

Pëlqimi është gjithashtu një nocion që përdoret në fusha të tjera të ligjit, **veçanërisht në kontrata**. Në këtë kontekst, për të siguruar vlefshmërinë e një kontrate, do të merren në konsideratë kritere të tjera nga ato të përmendura në Direktivë, të tilla si, mosha, etj.

Për të qartësuar rolin e pëlqimit në raste specifike, është i nevojshëm qartësimi i raportit ndërmjet pëlqimit dhe bazave të tjera për ligjshmërinë. Renditja në të cilën bazat ligjore përmenden në Nenin 7 qëndron, por kjo nuk do të thotë se pëlqimi është gjithmonë baza më e përshtatshme për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale.

Marrja e pëlqimit nuk lejon shmangien nga dispozita të tjera. Ai përbën kryesisht një bazë për ligjshmërinë, dhe jo për heqjen dorë (revokimin) nga zbatimi i parimeve të tjera.

Në disa transaksione mund të gjejnë zbatim disa baza ligjore njëkohësisht.

Shembull

Kontrolluesi mund të ketë të drejtë të përpunojë të dhëna personale në përputhje me qëllime të ndryshme dhe mbi baza të ndryshme ligjore:

- **Të dhënat e nevojshme për të blerë makinën: neni 7 (b),**
- **Për përpunimin e dokumenteve të makinës: neni 7 (c)**
- **Për shërbimet e menaxhimit të klientit (p.sh. që kryerjen e shërbimeve të makinës tek shoqëri të të njëjtit grup brenda BE-së): neni 7 (f),**
- **Për transferimin e të dhënave tek palë të treta për aktivitet e tyre të marketingut: neni 7 (a).**

Koncepte të lidhura ndërmjet tyre!

Kontrolli

Transparenca

Përdorimi i duhur i pëlqimit si bazë ligjore

Modalitetet/momenti: mënyrat e shprehjes së pëlqimit

Kontrolli, ka disa raste kur subjekti i të dhënave nuk është në pozicion që mund të marrë një vendim të vërtetë.

Për shembull, me dhënien e pëlqimit për publikimin e të dhënave personale në internet, ose për transferimin tek një subjekt i dyshimtë në një vend të tretë, subjekti i të dhënave mund të dëmtohet dhe kontrolluesi mund të argumentojë se subjekti i të dhënave ka rënë dakord për këtë gjë. Është e rëndësishme të rikujtohet koncepti kontroll. Pëlqimi absolutisht i vlefshëm nuk e çliron kontrolluesin nga detyrimet e veta, dhe as nuk legjitimon përpunimin.

Nocioni i kontrollit është i lidhur edhe me faktin se subjekti i të dhënave duhet të jetë në gjendje të tërheqë pëlqimin e tij. Tërheqja nuk ka efekte prapavepruese, por, në parim duhet të parandalojë çdo përpunim të mëtejshëm të të dhënave të individit nga ana e kontrolluesit.

Transparenca është një kusht për të pasur nën kontroll përpunimin dhe dhënien e pëlqimit të vlefshëm. Transparenca, në vetvete, nuk është e mjaftueshme për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale, por ajo është një kusht thelbësor për të siguruar që pëlqimi të jetë i vlefshëm.

Që pëlqimi të jetë i vlefshëm duhet që personi të informohet para se ai të japë atë. Kjo nënkupton që gjithë informacioni i nevojshëm duhet të jepet në momentin që kërkohet pëlqimi, dhe se këto informacione duhet të trajtojnë aspekte thelbësore të përpunimit që synohet të legjitimohet nga pëlqimi.

Modalitetet/momenti: mënyrat e shprehjes së pëlqimit.

Edhe pse momenti/koha e kërkimit të pëlqimit nuk është përcaktuar në Direktivë, kjo zbulohet qartë nga gjuha e dispozitave të ndryshme të cilat tregojnë se, si rregull i përgjithshëm, pëlqimi duhet të jepet përpara se përpunimi të fillojë.

Marrja e pëlqimit përpara fillimit të përpunimit të të dhënave është një kusht thelbësor për të legjitimuar këtë përpunim. Është e rëndësishme të theksohet fakti se pëlqimi ndryshon nga e drejta për të kundërshtuar.

Siç është përmendur edhe në Dokumentin e Punës Nr. 114 të Grupit të Punës: "***rëndësia e faktit se pëlqimi është një akt pozitiv përjashton de facto çdo sistem ku subjekti i të dhënave nuk gëzon të drejtën për të kundërshtuar transferimin pasi ky i fundit të ketë ndodhur***". Për këto arsye, e

drejta për të kundërshtuar nuk duhet të ngatërrohet me pëlqimin.

Përdorimi i duhur i pëlqimit si bazë ligjore.

Përdorimi i pëlqimit "në kontekstin e duhur" është element vendimtar. Përdorimi i tij në raste të përshtatshme, për shkak se ka pak gjasa që të përmbushen elementet që përbëjnë një pëlqim të vlefshëm, do ta bënte vetë atë të cenueshëm dhe, në praktikë, do të dobësonte pozitën e subjekteve të të dhënave.

Analizë e dispozitave

Koncepti i "pëlqimit të subjektit të të dhënave" përkufizohet në **Nenin 2 (h)** dhe përdoret më pas në **Nenet 7, 8 dhe 26** të Direktivës 95/46/EC. Roli i pëlqimit përmendet gjithashtu edhe në recitalet 30 dhe 45.

Sipas Nenit 2 (h) "**pëlqimi i subjektit të të dhënave**" do të thotë "**çdo shprehje specifike e dhënë lirisht dhe në dijeni të fakteve, e vullnetit të tij, me anë të së cilës subjekti pranon që të dhënat personale në lidhje me të, të përpunohen**".

"... çdo ... shprehje ... e vullnetit ... me anë të së cilës subjekti pranon ..."

Forma e shprehjes së vullnetit (d.m.th., mënyra e vënies në dukje të vullnetit) nuk përcaktohet nga Direktiva. Për arsye fleksibiliteti, pëlqimi **“me shkrim”** nuk është përfshirë në versionin final.

Duhet të theksohet se Direktiva përfshin "çdo" shprehje të vullnetit". Kjo lejon një interpretim shumë të zgjeruar të sferës së veprimit të një shprehje të tillë.

Pëlqimi duhet të përfshijë të gjitha format e shprehjes së vullnetit, me anë të së cilave subjekti i të dhënave lë të kuptohet miratimi i tij.

Ajo mund të përfshijë nënshkrimin me dorë në fund të një formulari shkresor, por edhe deklarata me gojë që vënë në dukje miratim, apo një sjellje nga e cila në mënyrë të arsyeshme arrihet në konkluzionin e pëlqimit.

Është e diskutueshme nëse mungesa e ndonjë sjellje, apo ndoshta më mirë e një sjellje pasive, gjithashtu mund të interpretohet si një shfaqje e vullnetit, në rrethana tepër specifike (dmth. në një kontekst haptazi të dallueshëm). Nocioni i **"shprehjes së vullnetit"** është i gjerë, por duket se nënkupton një nevojë për veprim.

Pëlqimi i bazuar në një mosveprim të individit apo në heshtjen e tij, sigurisht që nuk kualifikohet si pëlqimi i vlefshëm, sidomos në një kontekst online. Kjo është një

çështje që lind në veçanti në lidhje me përdorimin e parametrave automatike të cilat subjekti i të dhënave duhet t'i ndryshojë në mënyrë që të refuzojnë përpunimin. Për shembull, ky është rasti me përdorimin e kutive të klikueshme paraprakisht ose parametrat e browserit të internetit të cilat automatikisht lejojnë mbledhjen e të dhënave.

“... [shprehje]... e dhënë lirisht... [e vullnetit]”

Pëlqimi mund të jetë i vlefshëm vetëm nëse subjekti i të dhënave është, në të vërtetë në gjendje të zgjedhë, dhe nuk ka rrezik mashtrimi, frikësimi, kërcënimi, detyrimi, apo pasoja negative domethënëse nëse ai nuk jep pëlqimin. Nëse pasojat e pëlqimit minojnë lirinë individuale të zgjedhjes, atëherë pëlqimi nuk është i lirë.

Në parim, pëlqimi konsiderohet si i metë nëse nuk lejohet tërheqja efektive e tij.

Shembull

Përdorimi i skanerëve të trupit po bëhet gjithmonë e më i përdorshëm në disa ambiente publike, në veçanti në aeroporte për të hyrë në zonën e ngjitjes në avion. Duke pasur parasysh se të dhënat e udhëtarëve përpunohen në momentin e skanimit përpunimi duhet të përputhet me

një nga bazat ligjore të Nenit 7 të Direktivës.

Kalimi nëpërmjet skanerëve të trupit, ndonjëherë është një opsion për udhëtarët, që nënkupton se përpunimi mund të justifikohet me anë të pëlqimit të tyre.

Megjithatë refuzimi për të kaluar në skanerin e trupit mund të krijojë dyshime, ose shkakton kontrole shtesë, të tilla si kontrolli trupor. Shumë pasagjerë do të jepnin pëlqimin për tu skanuar, për arsye se duke vepruar kështu ata do të shmangnin probleme ose vonesa të mundshme, ndërsa prioritet i tyre primar është të mbërrijnë në bordin e fluturimit të tyre në kohë.

Ky pëlqim nuk është mjaftueshëm i lirë. Duke qenë se përpunimi duhet të provohet që është i nevojshëm (për arsye të sigurisë publike), baza për ligjshmërinë e tij nuk duhet të jetë Neni 7 (a), por në një akt tjetër ligjor, që parashikon detyrimin për bashkëpunim të udhëtarëve, Neni 7 (c) ose (e). Baza ligjore për ekzaminimin me anë të skanerit të trupit duhet të jetë ai akt, i cili mund të parashikojë një zgjedhje ndërmjet skanimit dhe kontrollit trupor, megjithatë kjo zgjedhje do t'i propozohet të interesuarit

vetëm si opsion plotësues, në kuadër të masave shtesë.

Nëse pëlqimi, në raste përjashtimore, mund të përbëjë një bazë të vlefshme për përpunimin e të dhënave personale nga Shtetet, duhet të kryhet një kontroll i plotë rast pas rasti për të vlerësuar nëse pëlqimi është me të vërtetë mjaftueshëm i lirë. Kur një autoritet publik është kontrolluesi i të dhënave, baza ligjore për të legjitimuar përpunimin do të jetë sipas një detyrimi ligjor dhe jo pëlqimi.

Kjo është e qartë në mënyrë të veçantë në rastin e përpunimit të të dhënave personale nga autoritete publike të veshura me kompetenca, të tilla si institucionet për zbatimin e ligjit që veprojnë në kuadër të detyrave të tyre në fushën e policisë dhe gjyqësorit.

Autoritetet policore nuk mund të mbështeten në pëlqimin e individit për marrjen e masave të cilat nuk janë parashikuar, ose ndryshe nuk mund të jenë të autorizuar me ligj.

Shembull

Censusi kombëtar

Gjatë një regjistrimi të censurit kombëtar, popullsisë i kërkohet t'i përgjigjet pyetjeve të ndryshme në lidhje me situatën personale dhe profesionale vetjake. Përgjigja e këtyre pyetjeve është e

detyrueshme. Përveç kësaj, censusi përfshin gjithashtu një pyetje, në lidhje me mjetet e transportit të përdorura nga ana e individit, përgjigja e së cilës është referuar qartë si fakultative.

Megjithëse nuk ka pëlqim të lirë për pjesën kryesore të censurit, për dhënien e përgjigjes së kësaj pyetje fakultative ka zgjedhje të lirë. Prapë se prapë, kjo nuk duhet të fshehë faktin se qëllimi kryesor i Shtetit që harton këtë pyetësor, është marrja e përgjigjeve. Si rregull i përgjithshëm, pëlqimi nuk përbën një bazë të vlefshme në këtë kontekst.

“... shprehje specifike ... [e vullnetit]”

Për të qenë i vlefshëm, pëlqimi duhet të jetë specifik. Me fjalë të tjera, pëlqimi blanket (i përgjithshëm) **që nuk specifikon qëllimin e saktë të përpunimit nuk është i pranueshëm.** Për të qenë specifik, pëlqimi duhet të jetë i kuptueshëm/i lexueshëm.

Duhet t'i referohet në mënyrë të qartë dhe të saktë qëllimit dhe pasojave të përpunimit të të dhënave.

"Pëlqimi specifik", pra, në thelb është i lidhur me faktin se pëlqimi duhet të jetë i informuar.

Pra, ekziston detyrimi “për të dhënë hollësi, detaje” të pëlqimit në lidhje

me elementët e ndryshëm që përbëjnë përpunimin e të dhënave.

Çështje:

Gjykata Evropiane e Drejtësisë (GJED) ka marrë një vendim paraprak në lidhje me Nenin 12 (2) të Direktivës për Privatësinë dhe Komunikimin Elektronik për sa i përket nevojës për rinovimin e pëlqimit të abonentëve (pajtimtarëve) të cilët tashmë kanë dhënë pëlqimin për publikimin e të dhënave të tyre personale në një numëroror telefonik, që të dhënat të transferohen për shërbime të tjera të numërororit.

Gjykata u shpreh se, nëse abONENTI ka qenë i informuar saktësisht për mundësinë që të dhënat e tij personale të transferoheshin tek një sipërmarrës i tretë dhe ai tashmë ka dhënë pëlqimin për publikimin e këtyre të dhënave në atë numëroror, pëlqimi nuk është i nevojshëm që të rinovohet nga ana e abonentit për transferimin e këtyre të dhënave të njëjta, nëse garantohet që të dhënat në fjalë nuk do të përdoren për qëllime të tjera nga ato për të cilat të dhënat janë mbledhur.

Megjithatë, një pëlqim i dallueshëm mund të jetë i nevojshëm nëse kontrolluesi synon të përpunojë të dhënat për qëllime të ndryshme. Por

një pëlqim shtesë i veçantë duhet të kërkohet për të mundësuar dërgimin e të dhënave të subjektivit tek palë të treta. Nevoja për dhënien e hollësive mbi detajet e pëlqimit duhet të vlerësohet rast pas rasti, në varësi të qëllimit (eve) ose marrësve të të dhënave.

“... [shprehje e vullnetit].... e informuar/në dijeni të fakteve...”

Elementi i fundit i përkufizimit të pëlqimit, po jo me më pak vlerë, siç do ta shohim më poshtë, është që ai duhet të jetë i informuar, pra i dhënë në dijeni të fakteve.

Në praktikë kjo do të thotë se "pëlqimi i subjektivit të të dhënave duhet të jetë i bazuar në një vlerësim dhe kuptim të fakteve dhe pasojave të veprimit.

Subjekti i të dhënave duhet të marrë, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, informacione të sakta dhe të plota mbi të gjitha çështjet përkatëse, në veçanti, ato të specifikuar në Nenin 10 dhe 11 të Direktivës, të tilla si natyra e të dhënave të përpunuara, qëllimet e përpunimit, marrësit e transferimeve të mundshme, dhe të drejtat e subjektivit të të dhënave. Duke përfshirë gjithashtu njohjen e pasojave në rast refuzimi të përpunimit në fjalë".

Pëlqimi i dhënë në dijeni të fakteve është veçanërisht vendimtar në kontekstin e transferimit të të

dhënave personale në shtete të treta. Kjo gjë kërkon që subjekti i të dhënave të jetë informuar drejt në lidhje me riskun specifik që të dhënat e tij mund të transferohen në një shtet i cili nuk ofron mbrojtje të nevojshme.

Sipas **Nenit 7 (a)** të Direktivës, pëlqimi i padyshimtë (haptazi i kuptueshëm) i subjektivit të të dhënave përbën një bazë ligjore për përpunimin e të dhënave personale. Kështu që, për të qenë i vlefshëm, përveç kritereve të përcaktuara në Nenin 2 (h), pëlqimi duhet të jetë **i padyshimtë (unambiguous)**.

Ky kusht detyron kontrolluesit të krijojnë procedura të shëndosha për dhënien e pëlqimit nga subjektivit e të dhënave.

Kontrolluesi i të dhënave duhet të jetë mjaft i sigurt që personi që jep pëlqimin është në të vërtetë subjekti i të dhënave. Kjo është e rëndësishme veçanërisht kur miratimi është dhënë me telefon ose online.

Gjithashtu pëlqimi duhet të jetë i verifikueshëm.

Shembull

Pëlqimi për marrjen e informacionit proporcional me postë të zakonshme.

Një hotel iu kërkon individëve të vendosin adresat e tyre postare në një formular, nëse dëshirojnë të marrin informacion promocial me postë të thjeshtë. Nëse individi, pas dhënies së adresës postare, nënshkruan formularin për të bërë të ditur pranimin e tij, atëherë kjo përbën pëlqimin të padyshimtë. Në këtë rast, pëlqimi është si i shprehur dhe me shkrim. Kjo procedurë i ofron kontrolluesit një provë të përshtatshme për marrjen e pëlqimit nga të gjithë klientët për aq sa kontrolluesi i ruan të gjithë formularët e nënshkruar.

Pëlqimi i shprehur mund të jepet edhe me gojë, me anë të deklaratave që lënë të kuptojnë miratim.

Shembull

Pëlqimi me gojë për të marrë informacion promocial. Ndërsa klientët e një hoteli janë duke bërë çregjistrimin për tu larguar nga hoteli, recepsionisti i pyet nëse dëshirojnë të japin adresën e tyre për të marrë informacion promocial nga hoteli. Pasi kanë dëgjuar kërkesën nga recepsionisti si dhe informacionin përkatës, individët që përgjigjen duke dhënë adresat e tyre postare do të konsiderohen se japin pëlqim të shprehur.

Megjithatë, Grupi i Punës thekson se në botën virtuale (online) ekziston

rezik më i lartë për dhënien e një pëlqimi të dyshimtë dhe prandaj kërkon vëmendje të veçantë.

Grupi i Punës konstaton se pëlqimi i bazuar në heshtjen e individit është i papërshtatshëm në kontekstin e marketingut të drejtpërdrejtë me anë të postës elektronike. "*Pëlqimi i nënkuptuar për marrjen e mesazheve të tilla nuk është në përputhje me përcaktimin e pëlqimit në Direktivën 95/46/EC po ashtu as kutizat ku duhet të klikohet si p.sh., në faqet e internetit, nuk janë në përputhje me përcaktimin e Direktivës*".

Shembulli i mëposhtëm konfirmon këtë qëndrim:

Një shitës librash me pakicë që operon online iu dërgon klientëve të tij besnikë një mesazh elektronik ku i informon se të dhënat e tyre do të transferohen tek një shoqëri reklamash, e cila planifikon t'i përdorë ato për qëllime marketingu. Përdoruesve iu lihet një afat kohor prej dy javësh për të dhënë përgjigje. Ata informohen gjithashtu se heshtja do të konsiderohej si pëlqim për transferimin. Ky lloj mekanizmi, ku pëlqimi buron nga një mosveprim i individëve, nuk përbën pëlqim të vlefshëm dhe është i dyshimtë. Në këtë rast, nuk mund të konstatohet se individët janë dakord për

transferimin duke u bazuar në mungesën e përgjigjes.

Neni 8 i Direktivës parashikon mbrojtje të veçantë për "kategori të veçanta të të dhënave", të cilat për nga natyra e tyre konsiderohen tepër sensitive. Përpunimi i të dhënave të tilla është i ndaluar, me përjashtim kur aplikohet, të paktën, një nga disa prej përjashtimeve të caktuara. Neni 8(2)(a) parashikon se ndalimi nuk zbatohet nëse subjekti i të dhënave ka dhënë **pëlqimin e tij të qartë** për përpunimin.

Në terma ligjore "**pëlqim i qartë**" ka të të njëjtin kuptim si "**pëlqimi i shprehur**". Ai përfshin të gjitha situatat ku individit i propozohet të pranojë apo kundërshtojë një përdorim të veçantë të të dhënave personale ose përhapjen e tyre, dhe ai reagon në mënyrë aktive ndaj pyetjes, me gojë ose me shkrim. **Zakonisht, pëlqimi i qartë ose i shprehur jepet me shkrim duke u nënshkruar me dorë.**

Në kundërshtim me dispozitat e Nenit 7 të Direktivës, pëlqimi në rastin e të dhënave personale sensitive, dhe për pasojë edhe të dosjeve shëndetësore elektronike, duhet të jetë i **qartë**.

Shembull.

Përdorimi i të dhënave shëndetësore për kërkime...

Rasti i një pacienti, i cili u informua nga klinika se kartela e tij mjekësore do të transferohej tek një studiues, përveç kur ai kundërshtonte (duke telefonuar një numër), nuk përmbush kërkesat e pëlqimit të qartë.

Neni 26.1, parashikon pëlqimin e padyshimtë të subjektit të të dhënave si përjashtim nga ndalimi për të transferuar të dhëna në shtete të treta jo të përshtatshme. Reflektimet e bëra më sipër në lidhje me Nenin 7 (a) zbatohen edhe këtu. Nga sa më sipër, pëlqimi i padyshimtë, konsiderohet kur individët ndërmarrin një veprim pohues që nënkupton pranimin e të dhënave për transferimin, për shembull, duke nënshkruar një formular pëlqimi ose duke kryer veprime të tjera që në mënyrë të pagabueshme mbështesin përfundimin se pëlqimi është dhënë.

Pëlqimi i dhënë nga individët që nuk zotërojnë aftësi të plota juridike

Sipas Direktivës 95/46/EC nuk ka rregulla të veçanta për marrjen e pëlqimit të individëve që nuk kanë zotësi të plotë juridike, duke përfshirë edhe fëmijët.

Përsa i përket fëmijëve, kushtet për dhënien e pëlqimit të vlefshëm ndryshojnë nga një shtet anëtar në tjetrin.

Harmonizimi i kushteve për lejimin e individë të paaftë për të ushtruar të drejtat e tyre në nivel të BE, veçanërisht në lidhje me prapun e moshës, me siguri do të sjellë garanci shtesë.

Megjithatë, Grupi i Punës është i vetëdijshëm se kjo shkon përtej fushës së veprimit të mbrojtjes së të dhënave pasi **prek në përgjithësi çështje civile.**

Gjithashtu duhet të parashikohet kërkesa për të përdorur mekanizma verifikimi online për moshën. Ka mekanizma të ndryshme dhe kufi moshe të ndryshëm.

Direktiva për Privatësinë dhe Komunikimin Elektronik (Direktiva 2002/58/EC)

e ndryshuar rishtazi është një lex specialis kundrejt Direktivës 95/46/EC për aq sa ajo ofron një regjim specifik të sektorit të veçantë në lidhje me privatësinë dhe komunikimin elektronik .

Neni 2(f) (Direktiva 2002/58/EC) – Pëlqimi dhe lidhja me Direktivën 95/46/EC.

“pëlqimi i përdoruesit ose abonentit”

Neni 2 i Direktivës për Privatësinë dhe Komunikimin Elektronik në mënyrë të qartë thotë se përkufizimet e Direktivës 95/46/EC do të zbatohen në lidhje me Direktivën 2002/58/EC. Neni 2 (f) thotë: ***“Pëlqimi nga një përdorues apo abonent përkon me pëlqimin e subjektit të të dhënave në Direktivën 95/46/EC”.***

Kjo do të thotë se kurdoherë që pëlqimi kërkohet në bazë të Direktivës për Privatësinë dhe Komunikimin Elektronik, kriteret që përcaktojnë nëse pëlqimi është i vlefshëm janë të njëjta si ato të përcaktuara në Direktivën 95/46/EC, përkatësisht përkufizimi në Nenin 2 (g) dhe specifikat në Nenin 7 (a).

Neni 5.1. - kur pëlqimi është i nevojshëm nga një ose të dyja palët

“... pëlqimi i përdoruesit në fjalë ...”

Neni 5 (1) i Direktivës për Privatësinë dhe Komunikimin Elektronik mbron fshehtësinë e komunikimit duke ndaluar çdo lloj përgjimi apo mbikëqyrje të komunikimeve pa pëlqimin e të gjithë përdoruesve të interesuar.

Në këtë rast, Neni 5 (1) kërkon pëlqimin e "të gjithë përdoruesve në fjalë", thënë ndryshe, të dyja palët në një komunikim. Pëlqimi i njërës

prej palëve nuk është i mjaftueshëm.

Nenet 6(3), 9, 13 dhe 5(3) - koha kur kërkohet pëlqimi

"... pas dhënies së informacionit të qartë dhe të kuptueshëm, ..."

Neni 6 (3) i Direktivës për Privatësinë dhe Komunikimin Elektronik përfshin një referencë të qartë të pëlqimit paraprak të abonentit ose përdoruesit në fjalë, ku parashikohet detyrimi për të dhënë informacion dhe të marrë pëlqimin paraprak para përpunimit të të dhënave të trafikut për qëllime të shërbimeve të marketingut të komunikimeve elektronike ose të shërbimeve me vlerë të shtuar.

Neni 13(2-3) - e drejta për të kundërshtuar dhe dallimi i saj nga pëlqimi.

Nëse marrësi i komunikimit komercial është një klient ekzistues dhe komunikimi synon promovimin e produkteve të veta ose të ngjashme ose shërbimeve të ofruesve, kërkesa nuk është pëlqim, por garantim që individëve **"ti jepet mundësia për të kundërshtuar"**.

Nenet 6.3, 9.3-9.4. - mundësia për të tërhequr pëlqimin.

"... mundësia për të tërhequr pëlqimin në çdo kohë..."

"Sipas Nenit 9 të Direktivës 2002/58/EC, individët që kanë dhënë pëlqimin e tyre për përpunimin e të dhënave të vendndodhjes përveç të dhënave të trafikut mund të tërheqin pëlqimin e tyre në çdo kohë dhe duhet të kenë mundësinë, duke përdorur një mjet të thjeshtë dhe pa pagesë, për të refuzuar përkohësisht përpunimin e të dhënave të tilla. Grupi i punës për sa i përket këtyre të drejtave, të cilat mund të merren si zbatim i të drejtës për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave të vendndodhjes, i sheh si thelbësore, duke parë edhe natyrën e ndjeshme të të dhënave të vendndodhjes.

Fund

Meqenëse nocioni i **"Pëlqimit"** është shumë i rëndësishëm në përpunimin e të dhënave personale në respektim dhe të kërkesave të ligjit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale Nr.9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar, ky material ndihmon zbatuesit e ligjit në lidhje me kuptimin e saktë të këtij termi duke pasqyruar aspekte të ndryshme të tij në mënyrë që ai të zbatohet siç duhet dhe vihet në praktikë.

